

Ditari Naturës



Nr. 42

Viti i katërt i botimit

Nëntor 2016

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Takim koordinues për shpëtimin e kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti
- Takim rajonal i programit “Menaxhimi i ligatinave dhe ruajtja e pelikanit kaçurrel”
- Inventari për sistemin e monitorimit të faunës së egër
- Instalohen bova sinjalizuese në Parkun Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”
- Si t’i drejtohem gjykatës / nga Lex Ferenda, Milieukontakt Shqipëri dhe Ecoalbania
- PUZZLE ENERGJIE - Ekspozitë Fotografish / nga Qendra EDEN
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se 50 vjet më parë ...

Me VKM nr. 96, datë 21.11.1966 shpallen Parqe Kombëtare, kryesisht ekosistemet pyjore, si më poshtë:


1. Thethi, me sip. 2630ha; 2. Lura, me sip. 1280ha; 3. Llogara, me sip. 1010ha; 4. Bredhi i Drenovës, me sip. 1380ha; 5. Dajti, me sip. 3300ha dhe 6. Pisha e Divjakës, me sip. 1250ha.

Aktualisht, bazuar në dispozitat e ligjit “Për

zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, disa prej tyre kanë ndryshuar sipërfaqen, duke ruajtur statusin e Parkut Kombëtar.

Parku Kombëtar “Thethi”, sipas studimit të ri që po kryhet, do të përfshihet në sipërfaqen e Parkut Kombëtar Ndërkufitar “Alpet e Shqipërisë”, me sipërfaqe të përgjithshme 86 mijë ha. Parku Kombëtar “Dajti”, me VKM nr. 402, datë 21.06.2006, u rishpall “Park Kombëtar” me sipërfaqe të zgjeruar 29,384.18ha, i shtrirë në Qarkun e Tiranës dhe të Durrësit.

Vijon në faqe 2



Vjeshtë në PK Shebenik-Jabllanicë © Foto INCA

Organizatrat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Vijon nga faqe 1 Parku Kombëtar “Pisha e Divjakes”, me VKM nr. 687, datë 19.10.2007, u rishpall Park Kombëtar “Divjakë-Karavasta”, me sipërfaqe të zgjeruar 22.230.2 ha, në të cilin përfshihet edhe pjesa e territorit në administrim të Kavajës (Gosë) dhe Fierit (Libofshë). Gjithashtu, pjesë e Parku Kombëtar, u bë dhe laguna e Karavastasë, me sip. 5000 ha, e cila sipas VKM nr. 102, datë 15.1.1996 kishte statusin “Rezervat Strikt Natyror”. Njëherazi, ky territori, si ekosistem natyror veçanërisht i mbrojtur, ka statusin e Zonës Ramsar, me VKM nr. 413, datë 22.8.1994...

... 11 vjet më parë ...

... me VKM nr. 684, datë 02.11.2005, shpallet zona shqiptare e Liqenit të Shkodrës “Rezervat Natyror i Menaxhuar”, ndërsa me VKM nr. 682, datë 02.11.2005, shpallet “Peizazh ujor/tokësor i mbrojtur” zona e lumit Buna, së bashku me delten dhe ishullin e Franc Jozefit, rezervatin e Velipojës, lagunën e Vilunit, plazhin e Baks-Rrjollit, kënetën e Domnit, si dhe territoret përreth tyre.

Për Rezervatin Natyror të Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës” është hartuar dhe plani i menaxhimit (Qershor të vitit 2012), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr. 815, datë 21.11.2012, por që fatkeqësisht nuk po zbatohet, pasi ka disa kundërshti në lidhje me zonimin e territorit dhe të mungesës së fondeve.

Me VKM nr. 683, datë 02.11.2005, sipërfaqja prej 49,562.0ha, e cila përfshin Liqenin e Shkodrës sëbashku me Lumit e Bunës dhe zonat ligatinore përreth tyre, të shpalljen zonë natyrore veçanërisht të mbrojtur dhe përfshirjen në listën e Konventës “Ramsar”, “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”...

...6 vjet më parë ...

...me VKM nr.995, datë 03.11.2010, ekositemi natyror ligatinor i deltës së Lumit Mat, laguna e Patokut, Godulla dhe delta e Lumit Ishëm, me sip. 5000.7ha, shpallet “Rezervat Natyror i Menaxhuar”.

VKM nr.693, datë 10.11.2005, rishpall “Park Kombëtar” territoret natyrore të kompleksit ligatinor të Butrintit deri tek Kepi i Stillos, me

sip. 8591.2ha. Për këtë park është hartuar dhe plani i menaxhimit (Shtator 2010), i miratuar me urdhër të Ministrit të Mjedisit nr.404, datë 09.06.2011, por që nuk ka gjetur zbatim.

Njëherazi, territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (Liqeni i Butrintit, Parku Kombëtar i Butrintit, Kepi i Stillos, ishujt e Ksamilit) ka statusin e Zonë Natyrore veçanërisht e mbrojtur, për t’u përfshirë në listën e Konventës “Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë”, me sipërfaqe të përgjithshme 13,500.0ha.

VKM n.881, datë 03.11.2010, caktoi vendet për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radiotelevizive në territorin e Parkut Kombëtar “Mali i Dajtit”...

...4 vjet më parë ...

...miratohet ligji nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”. Ligj synon: a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore, qofshin të përkohshme apo të përhershme, të ujërave të brendshme detare, të ujërave territoriale, zonave ekonomike ekskluzive, shelfit kontinental, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; b) sigurimin, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit; c) shpërndarjen e drejtë të burimeve ujore, sipas qëllimeve të përdorimit dhe drejtimin e administrimit e efektshëm të tyre; ç) mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shpërdorimi dhe harxhimi mbi nevojat faktike; dhe d) përcaktimin e kuadrit institucional, në nivel kombëtar e vendor, për vënien në jetë të një politike kombëtare për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore në të mirë të komunitetit dhe interesave sociale dhe ekonomike të vendit.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për krenntimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

Takim koordinues mbi problemin e shpëtimit të kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti

Ditën e mërkurë, në datë 05.10.2016, në ambientet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua takimi koordinues mbi "Problemin e shpëtimit të kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti". Në takim morën pjesë Drejtori dhe stafi i Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Mjedisit, Drejtori i Përgjithshëm dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, përfaqësues të Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), përfaqësues të Fondacionit 4 PUTRAT, përfaqësues të shoqatës Animal Rescue Albania (ARSA) dhe përfaqësues të shoqatës për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve (ASPB). Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura z.Zamir Dedej që drejtoi takimin, bëri një prezantim mbi punën që është kryer deri tani për shpëtimin e kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti duke theksuar arritjet unike në vitin 2016 si në rezultate konkrete (shpëtimi i 16 arinjve) ashtu edhe në lidhje me sensibilizimin e opinionit publik (ka një numër pronarësh lokalësh dhe mbajtës arinjsh që janë të gatshëm të dorëzojnë ata vullnetarisht). Në fjalën e tij ai theksoi që ky takim është fillimi i një



nje nisme qe ka per qellim koordinimin dhe bashkerendimin e aktiviteteve apo projekteve qe mund te zhvillohen me ne fokus shpëtimin e kafshëve qe mbahen ne roberi, ne menyre te paligjshme dhe se ky takim duhet konsideruar si i pari i nje koordinimi te sukseshem. Z.Dedej falenderoi të gjithë aktorët e përfshirë deri më tani në këtë proces dhe theksoi vullnetin e mirë politik që egziston dhe është i dukshëm nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Mjedisit si dhe përmendi edhe bashkëpunimin e shkëlqyer dhe kontributin e dhënë nga Bashkia Tiranë.

Nërsa z.Dragoti përfaqësuesi i INCA në fjalën e tij falenderoi drejtorinë e Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura të cilët gjatë këtij viti kanë bërë të mundur zbatimin e ligjit "Për Mbrojtjen e faunes së eger". Në fjalën e tij ai pasqyroi disa projekte që INCA po implementon si: trajnimet me në fokus shpëtimin e kafshëve në gjendje kaptiviteti, inventarizimin në shkallë vendi të llojeve të kafshëve të egra në gjendje kaptiviteti si dhe inventarizimin e llojeve të ballcamosura dhe të trofeve të ndryshme

Takim rajonal i programit "Menaxhimi i ligatinave dhe ruajtja e pelikanit kaçurrel në pellgun e mesdheut"

Divjakë - 10 Tetor 2016 - Në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, u zhvillua takimi i përbashkët me pjesëmarrjen e partnerëve të programit "Menaxhimi i ligatinave dhe ruajtja e pelikanit kaçurrel në pellgun e mesdheut". Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i arritjeve dhe diskutimi i përbashkët për vijueshmërinë e punës së mirë të deritanishme dhe sfidat për të ardhmen.



Inventari për sistemin e monitorimit të faunës së egër

Përfundoi trajnimi mbi Inventarin për sistemin e monitorimit të faunës së egër me rangers-at e 12 AdRZM-ve të vendit.



Ky sistem synohet të krijohet për regjistrimin dhe monitorimin e faunës së egër dhe do të jetë dokumenti kryesor që shërben për mbrojtjen dhe menxhimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe komponentëve të tij si dhe për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë.

Qëllimi kryesor i këtyre aktivitetve ishte të sigurojë informacionin e duhur përmes monitorimit, lidhur me tendencat në popullatat e faunës së egër si dhe mbi trysninë dhe kërcënimet në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i ruajtjes dhe vendimarrja ndaj saj. Ekspertiza u fokusua në identifikimin e nevojave për ngritjen e kapaciteteve institucionale të stafeve në procesin e monitorimit të faunës si në teori ashtu edhe në praktikën monitoruese në terren. Në zbatimin e këtyre aktiviteteve një rol i rëndësishëm po i jepet rojeve mjedisore (rangers-ave) dhe pëfshirjes së tyre gjatë gjithë procesit. Gjatë trajnimit rangers-at u njohën me procesin e monitorimit, parimet

dhe detyrimet e sistemit të monitorimit të faunës së egër (SiMF), ngritjen e patrullave dhe detyrat monitoruese të tyre, monitorimi i jetës së egër, monitorimin e kafshëve të egra të ngordhura, përdorimin i Sistemi Global të Pozicionimit (Global Positioning System-GPS), aktivitetet e jashtëligjshme, prezantimi me NATURA 2000 etj.

Ata u njohën me mënyrën e plotësimit të formularët dhe formatet e nevojshme të hartuar në përputhje me kërkesat e Direktivës Evropiane në shërbim të procesit të monitorimit, por edhe se si do të kryhen patrullimet dhe mënyrat e raportimi.

Në trajnim morën pjesë rangers-at e 12 AdRZM-ve si dhe ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të fushës.



Instalohen bova sinjalizuese në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan

Vlorë, 19 Tetor 2016 - Përfundon procesi i vendosjes së bovave sinjalizuese në Parkun Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Vendosja e tyre u bë e mundur në kuadër të projektit “Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në zonat e mbrojtura detare të mesdheut” i cili zbatohet nga INCA si dhe falë bashkëpunimit të ngushtë me UNDP dhe AdRZM Vlorë.



Si t'i drejtohem gjykatës !

Më 5 Tetor 2015 u zhvillua në Përmet trajnimi 'E drejta për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore', pjesë e serisë së trajnimeve të zhvilluar në kuadër të projektit HELP-CSO (Forcimi i Legjislacionit Horizontal dhe Promovimi i OSHC-ve). Tematika e trajnimit lidhej me aftësimin e organizatave lokale në aksesin në drejtësi dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës për çështje mjedisore. Trajnimi ishte konceptuar bazuar mbi një analizë të bërë rreth mungesës së njohurive që kanë OSHC-të mbi legjislacionin horizontal, raporti i të cilës do të publikohet në fund të projektit. Pjesëmarrësit në trajnim, që vinin kryesisht nga shoqëria civile, biznesi dhe Bashkia Përmet shprehën interes për njohuri më të thelluara për të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës si dhe u ushtruan në punë në grupe për plotësimin e një Formulari Kërkese për Informacion dhe Formulari Ankese duke përzgjedhur një problematikë të

caktuar. Gjatë muajit Tetor, 2016 do të testohen njohuritë e marra nga pjesëmarrësit nëpërmjet një pyetësori për të evidentuar më pas shkallën e aftësimin të të trajnuarve. Organizatat kërkuan më shumë bashkëpunim me projektin që ka si prioritet ofrimin e asistencës ligjore falas për çështjet mjedisore që do të evidentohen gjatë periudhës 1 vjeçare të tij. Pjesë e trajnimit ishte dhe një vizitë në terren, pranë HEC-it të Lanagaricës ku u demonstruan metoda praktike të matjes së parametrave të ujit, në ndihmë të OSHC-ve për të lehtësuar proceset e tyre të monitorimit. Ky trajnim u zhvillua nga Lex Ferenda, Milieukontakt Shqipëri dhe Ecoalbania në kuadër të projektit Achieve, implementuar nga REC Shqipëri dhe financuar nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri.

*nga Lex Ferenda,
Milieukontakt Shqipëri dhe Ecoalbania*

PUZZLE ENERGJIE - Ekspozitë Fotografish

Ditën e premtë datë 28 tetor 2016 Qendra EDEN organizoi një ekspozitë fotografish me temë “Energjia” e titulluar “PUZZLE ENERGJIE”, e cila u mbajt te Qendra Rinorë, rruga e Kavajës, Tiranë.



Fotografitë e paraqitura në këtë ekspozitë ishin sjellë nga qytetarët nga e përditshmja dhe tregonin perceptimin e secilit për këtë sektor i cili është i pranishëm në çdo sferë të zhvillimit të shoqërisë. Fotografi të tjera të paraqitura në ekspozitë ishin sjellë nga Qendra EDEN në sajë të vizitave në familje të ndryshme për hartimin e botimit “Varfëria Energjetike në Evropën Juglindore: Mbijetesë e të ftohtit” (http://www.eden-al.org/images/Publikime/Energy-Poverty-in-South-East-Europe_Surviving-the-Cold.pdf), ku paraqiten kushtet e familjeve në rajon të cilat kanë vështirësi në sigurimin e nevojave të përshtatshme të të ngrohtit të të ftohtit etj në familjet e tyre. Ekspozita u shoqërua me prezantimin e botimit “EVROPA JUGLINDORE: RRUGA DREJT BE-së APO RRUGA DREJT ASKUND: Një udhërrëfyes i energjise për vitin 2050: Një udhëzues për të ardhmen” (<http://www.eden-al.org/images/Publikime/SEESEP-GUIDE-ALB-web.pdf>). Botimi është i bazuar në dy produktet kryesore të projektit “Politika të qëndrueshme energjetike në Evropën Juglindore-SEE SEP”, Modeli i energjisë (<https://see2050energymodel.net/>) dhe Llogaritësi i Karbonit (<https://www.see2050carboncalculator.net/>).

Të pranishmit u njohën më raportin me dy rrugët kryesore të zhvillimit të sektorit të energjisë deri në vitin 2050 “Rruga drejt BE-së” dhe “ Rruga drejt Askund”. Rruga drejt BE-së” është rruga

drejt një sistemi të qëndrueshëm, eficient të energjisë së rinovueshme, duke mundësuar vendet për të përbushur synimet e BE-së dhe anazhimet ndërkombëtare klimatike. Rruga drejt askund” mbështetje e vazhdueshme në lëndët djegëse fosile, me fokus në impiante e reja të qymyrit, dhe nuk ka përpjekje për rritjen e efikasitetit të energjisë. Mesazhi kryesor i përcellë nëpërmjet këtij botimi të të pranishmit ishte “Energji më e pastër dhe më e qëndrueshme është më mirë për ne, për fëmijët tanë, për mjedisin dhe për klimën”. Për secilin sektor të kërkesës dhe të nevojës për energji u paraqitën skenarë të ndryshëm zhvillimi sipas secilës rrugë duke patur gjithmonë parasysh zvogëlimin e gazeve serrë deri në 85-90% në krahasim me vitin bazë 1990. Raporti është një studim i cili përfshin 7 vende ku projekti është zbatuar, duke bërë dhe një analizë gjithëpërfshirëse të Evropës Juglindore. Përshkrimi i zhvillimit aktual dhe parashikimet që paraqiten deri në 2050 e bëjnë këtë botim unik në llojin e tij dhe nxitës për tu lexuar jo vetëm nga qytetarët, por dhe nga teknikë dhe ekspertë të këtij sektori. Si rrjedhim, një botim i dytë është përpiluar “EVROPA JUGLINDORE: RRUGA DREJT BE-së APO RRUGA DREJT ASKUND: Një udhërrëfyes i energjise për vitin 2050: Një analizë teknike” (http://www.eden-al.org/images/PDF/South-East-Europe_The-EU-Road-or-the-Road-to-Nowhere_An-Energy-Roadmap-for-2050-Technical-Analysis.pdf) i cili ka një gjuhë më teknike dhe fton të gjithë të interesuarit për ta shfletuar e për ta përqasur atë sa herë që kemi nevojë për të bërë vlerësime aktuale apo drejt vitit 2050 të sektorit të energjisë në vendin tonë dhe në rajon.



Secili është në gjendje të vlerësojë rrugën që duket më e përshtatshme për zhvillimin vendit të tij dhe të përçojë mesazhin nëpërmjet zgjedhjeve që kryen duke përdorur Modelin e Energjisë (<https://see2050energymodel.net/>) dhe Llogaritësin e Karbonit (<https://www.see2050carboncalculator.net/>) dhe duke u bazuar në analizën që paraqitet në botimet. Fotografitë e energjisë ishin të vendosura në mënyrë të çrregullt duke dhënë idenë e një "PUZZLE" të pa formuar me një pamje të plotë, dhe ishin vetë të pranishmit që do të ideonin një pamje sipas përciptimit të tyre. Ekspozita u ndoq me një votim për foton më të bukur dhe që kishte mesazhin më të mirë përcjellës. " Çdo investim që ne marrim dhe konsiderojmë për vendin tonë, duhet të marri parasyh jo vetëm fitim njerëzor, por të këtë parasyh që të jetë një zhvillim i qëndrueshëm e të vlerësojë çdo të gjallë në këtë tokë- shprehet Ines Cilka fituese e çmimit të parë. Fituesi u vlerësua me materiale të cilat ndikojnë në përmirësimin e efikasitetit në banesat tonë si një Llampë LED, një izolues

dritarësh si dhe materiale promovuese të projektit.

Falenderojmë të gjithë që ishin pjesë e kësaj ekzpozitë me fotografitë dhe me praninë e tyre dhe lehtësimin e Qendrës Rinore për zhvillimin e aktivitetit.

Ky aktivitet u zhvilluar nga Qendra mjedisore EDEN dhe Grupimi Ekolëvizja të cilat janë zbatueset në nivel kombëtar të projektit rajonal "Politika të qëndrueshme energjetike në Evropën Juglindore-SEE SEP", i zbatuar në 7 vende (Bosnje dhe Hercegovina, Kosovë, Kroaci, Mal i Zi, Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri) me oragnziatë drejtuese SEE Change Net dhe mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Fotografitë e aktivitetit i ndiqni nëpërmjet këtij linku (https://www.facebook.com/Qendra-EDEN-EDEN-Center-319334287560/photos/?tab=album&album_id=1015422536011256)

Nga Qendra EDEN

NJOFTIME

8 Nëntor - Dita Botërore e Urbanizimit

18 Nëntor - Dita Botërore e Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS)

25 Nëntor - Dita Ndërkombëtare e Eleminimit të Dhunës ndaj Grave

1 - Njoftim / CO-SEED WWF njofton fituesit e grantit në kuadër të: Programi i Grantit CO-SEED / Programi i Grantit për Ndërtimin e Kapaciteteve dhe Advokaci të Shoqërisë Civile <http://www.inca-al.org/index.php/sq/item/534-njoftim-per-shtyp-co-seed>

2 - Për të lexuar "*Ditari i Natyrës*" në vite... / <http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme. Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme. Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, 1001, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania